

webertec aquaseal 2K

Hidroizolues ekstremisht fleksibël me 2 komponentë



■ Përshkrimi

webertec aquaseal 2K është hidroizolues me 2 komponentë, me bazë çimento dhe i modifikuar me polimerë. Ka në përbërje 25kg pluhur me bazë çimento të përforcuar me aditive dhe 10kg polimerë të lëngshëm.

■ Avantazhet

- Hidroizolues fleksibël
- Super rezistent ndaj presionit të ujit
- I përshtatshëm për pishina, tarraca, veranda, themele etj.

■ Përdorimi

- **webertec aquaseal 2K** përdoret për hidroizolim të sipërfaqeve të mëdha në ambiente të brendshme dhe të jashtme
- Mbron tarracat, themelet, pishinat etj nga ndikimet e lagështisë
- **webertec aquaseal 2K** është bazamenti i duhur për instalimin e sigurtë të pllakave në zona të ndikuara vazhdimisht nga uji, si basene ujore, pishina, shatërvane etj.
- Produkti nuk është i përshtatshëm si shtresë perfundimtare.

■ Përgatitja e bazamentit

- Bazamentet duhet të jenë të fortë, të thatë, të pastër dhe të niveluar. Bazamentet jo të qëndrueshëm apo me pjese që shkeputen duhet të riparohen para fillimit të punimeve. Për unifikimin e perthithjes së bazamentit duhet të trajtohet me astarin / bazën e përshtatshme.
- Sipërfaqja e punës duhet të jetë e mbrojtur me rrjetë skelash nga impakti i drejtpërdrejtë i erës, diellit apo shiut, këshillohet të mos kryhen punime në kushte të papërshtatshme të motit

- Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi +5°C dhe nën +30°C

■ Udhëzime mbi aplikimin

- Përmbajtja e thatë e thesit prej 25kg të komponentit (A) duhet të shtohet ngadalë në 10kg e komponentit të lëngshëm (B) duke e përzier me mikser elektrik me xhiro të ulta.
- **webertec aquastop 2K** aplikohet në të gjithë sipërfaqen e dëshiruar me mallë në minimalisht 2 shtresa.
- Shtresa e dytë mund të aplikohet me forcë nëse i shtohet me shumë komponent B derisa të arrihet konsistenca e dëshiruar.
- Aplikimi i secilës shtrese pasardhëse do të bëhet në drejtim pingul me drejtimin e shtresës paraardhëse.
- Në asnjë rrethë mos holloni komponentin B me ujë.
- Këndet, cepat dhe carjet e tubacioneve duhet të mbrohen dhe izolohen me aksesoret hidroizolues të games **webertec**. Shiritat hidroizolues duhet të vendosen midis 2 shtresave të hidroizoluesit të përgatitur.
- Këshillohet që produkti të përdoret me rrjete me fibra qelqi për të rritur elasticitetin e hidroizoluesit. Rrjeta duhet të vendoset midis 2 shtresave të hidroizoluesit.
- Për rezultate të kënaqshme këshillohet që shtresa perfundimtare hidroizoluese duhet të jetë të paktën 2mm – 3mm trashësi.
- **webertec aquastop 2K** nuk është i përshtatshëm si shtresë perfundimtare, kështu që do të duhet të vishet me shtresën mbrojtëse të përshtatshme.

**Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.*

webertec aquaseal 2K

Hidroizolues ekstremisht fleksibël me 2 komponentë



■ Siguria e produktit

- Përbërësit e rrezikshëm të përbërjes: çimento Portland



Rrezik

Mund të çojë në dëmtime të rënda të syrit. Shkakton acarim të lëkurës. Mund të shkaktojë reaksione alergjike të lëkurës. Mund të shkaktojë acarim të organeve të frymëmarrjes. Vishni doreza mbrojtëse, rroba mbrojtëse, syze mbrojtëse dhe mbrojtje për fytyrën. **NË RAST KONTAKTI ME SYTË:** Shpëlajeni me kujdes me ujë për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit, nëse ka, dhe nëse është e mundur. Vazhdoni të shpëlani. Telefononi menjëherë QENDRËN E KONTROLLIT TË HELMIMIT ose kontaktoni një mjek. **NË RAST KONTAKTI ME LËKURËN:** Shpëlajeni me ujë të bollshëm dhe sapun. **NË RAST THYMËRI:** Çojeni personin në ajër të pastër dhe vendoseni në një pozicion që lehtëson frymëmarrjen. Përmbajtja e kromit të tretshëm Cr (VI) në produkt është më pak se 0.0002% e llogaritur në masën totale të çimentos së thatë.

■ Asgjësimi

Produkti i papërdorur dhe paketimi bosh nuk mund të hidhen jashtë hapësirave të menaxhimit të mbetjeve. Shikoni fletën e të dhënave të sigurisë së produktit dhe kërkesat legjislative për më shumë informacion.

■ Veglat

Për miksim: mikser elektrik
Për rrafshim: furçe ose mallë metalike

■ Jetëgjatësia

12 muaj, i magazinuar mbi paletë në zona të thata dhe pa ndikim të drejtpërdrejtë nga kushtet e motit. Duhet mbrojtur nga ngrica.

**Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.*



webertec aquaseal 2K

Hidroizolues ekstremisht fleksibël me 2 komponentë

Tabela e te dhenave teknike

Lloji i paketimit	Set = thes letre + bidon plastik	
Sasi për njësi	25 kg / thes 10 kg / thes	35 thesë / paletë 35 bidona / paletë
Ngjyra	Pluhuri : gri Rezina: të bardhë	
Kokërrzimi	0.7 mm	
Konsumi	2 - 3 kg/m ²	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese dhe në varësi të karakteristikave të bazamentit dhe teknikës së aplikimit.
Trashësia e shtresës	2 – 3 mm	Trashësia totale

Treguesit fiziko-mekanike

PARAMETRAT	VLERA MESATARE	NJËSIA MATËSE
Aftësia për të kaluar çarjet në kushte standarde:	1.63	mm
Papërshkueshmëria nga uji:	2.1	%
Gjendja	Thesi: Pluhur Bidoni: e lëngët	

*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.